



ALBANIAN A1 – STANDARD LEVEL – PAPER 1
ALBANAIS A1 – NIVEAU MOYEN – ÉPREUVE 1
ALBANÉS A1 – NIVEL MEDIO – PRUEBA 1

Monday 8 May 2000 (morning)
Lundi 8 mai 2000 (matin)
Lunes 8 de mayo 2000 (mañana)

3 hours / 3 heures / 3 horas

INSTRUCTIONS TO CANDIDATES

- Do not open this examination paper until instructed to do so.
- Section A: Write a commentary on one passage. Include in your commentary answers to all the questions set.
- Section B: Answer one essay question. Refer mainly to works studied in Part 3 (Groups of Works); references to other works are permissible but must not form the main body of your answer.

INSTRUCTIONS DESTINÉES AUX CANDIDATS

- Ne pas ouvrir cette épreuve avant d'y être autorisé.
- Section A : Écrire un commentaire sur un passage. Votre commentaire doit traiter toutes les questions posées.
- Section B : Traiter un sujet de composition. Se référer principalement aux œuvres étudiées dans la troisième partie (Groupes d'œuvres) ; les références à d'autres œuvres sont permises mais ne doivent pas constituer l'essentiel de la réponse.

INSTRUCCIONES PARA LOS ALUMNOS

- No abra esta prueba hasta que se lo autoricen.
- Sección A: Escriba un comentario sobre uno de los fragmentos. Debe incluir en su comentario respuestas a todas las preguntas de orientación.
- Sección B: Elija un tema de redacción. Su respuesta debe centrarse principalmente en las obras estudiadas para la Parte 3 (Grupos de obras); se permiten referencias a otras obras siempre que no formen la parte principal de la respuesta.

SEKSIONI A

Shkruani nje koment te shkurter per pasazhin e meposhtem.

1. (a)

S'kishte qelluar asnjehere qe te hapej fjala se do te kishte lufte e pastaj te behej paqe. Kurse e kunderta, pas shpresave per paqe te shpallej befaz lufta, kjo ishte pothuajse e zakonshme ne gadishullin e madh.

5 Nganjehere dukej se gadishulli ishte vertet i madh dhe kishte vend per te gjitha: per gjuhe e fe te ndryshme, per nje dyzine popujsh, shtetesh, mbreterish e principatash, madje edhe per tri perandori, dy prej te cilave, ajo e serbeve dhe e bullgareve ishin shembur, kurse e treta, ajo bizantinia, per turp te vet e te krishterimit mbare, ishte shpallur nderkaq vasale e turqve.

10 Mirepo vinin dite te tjera qe ne mendjen e njerezve ndodhnin ndryshime dhe gadishulli ngjante i ngushte. Ndjenjat e ngushtesise, me shume se nga trojet dhe gjuhete e popujve qe perkiteshin me njeri-tjetrin shtohesh prej kujtimeve te vjetra. Ishin makthe qe popujt i bluanin ne vetmi, gjersa vinte nje dite qe ngjanin te paduruesheme.

15 Kjo ndodhte zakonisht ne pranvere, kur bashke me peshperimat per lufte ose per paqe, ndihej gjithkund nje trazim i pashpjegueshem. Ne te vertete parashikimet e mbara ose te prapa nuk reshtnin kurre ne zonat e ulta e kryesisht ne qytete. Por ato beheshin zoteruese kur bashkoheshin me trazimin qe zbriste prej njerezve te lartesive. Dhe kjo ndodhte ne 20 pranvere, fill pas shenjave te para te shkrirjes se debore. Shpjegimi ishte i thjeshte: ndonese parathenmet e qytetareve bazoheshin ne lajme e peshperima te perhapura andej-kendej prej tregetareve endacake, karrocierëve te konsujve, kursit te shkembimit te 25 dukatit venedikas ne bankat e Durresit, spiuneve, epileptikeve e lavirave te porteve, pra, ndonese rridhnin prej burimeve te besueshme, ato, per t'u kthyer ne peshperima te verteta, kishin nevojë per permase tjeter: te parrokshme e mistenoze, me fjale te tjera te palogjikshme. Kete ua siguronin njerezit e lartesive.

Per keta te fundit, qe nga Bjeshket e Namuna te Shqiperise, ne Mal te Zi, e gjer te 25 Olimpi i moçem e te Karpatet, gjithçka lidhej me deboren. Ashtu si njerezit e qyteteve, qe kishin prirjen ta perfitonin boten pergjithesisht te rrafshte, njerezit e maleve benin gabimin e kundert: besonin ne zoterimin e lartesive. Keshtu per ta, edhe sikur dikush te bente be e rufe se e kishte pare me sy ushrine qe ishte nisur per lufte, ata kthenin syte nga debora e tundnin hyet per te thene "jo". Gjersa ajo bablokja ishte aty, s'kishte ushtn 30 qe levizte e s'kishte lufte qe fillonte.

Ne pranvere e gjithë kjo siguri shembej dhe bashke me ujerat rrjedhja e mendimeve ndryshonte.

35 Keshtu ndodhi edhe ate pranvere te vitit 1389, kur fill pas lajmeve se do te kishte nje paqe te pazakonte, erdhi lajmi tjeter se do te kishte lufte dhe se, pikerisht kjo do te ishte e tille, e pazakonte.

Ismail Kadare *Tri kenge per Kosoven* 1998

- Cili eshte mesazhi I autorit ne fragmentin e noveles "Tri kenge zie per Kosoven"?
- Cili eshte mendimi I autorit per fatin historik te Ballkanit?
- Cili eshte reagimi juaj ndaj ideve te shprehura ne kete pasazh?

1. (b)

DESHIRE

Me vjen turp te qaj I heshtur,
Si nje shelg perbri moçalit !
Dua te gjemoj pareshtur,
Porsi lisi maje malit.

5 Rreth kurores, shpeseria
Le te mos me cicerojne:
Qe prej zgavrave te mia,
Shkabat le te vigjelojne.

10 Deget e fuqishme dua
Te me tunden neper ere
Papushuar permbi mua
Bore e virgjer le te bjere.

15 Siper akujve te ftohte,
Do te ngjitem gjer ne rete;
S’do me vije keq ne, ndodhte
Te zhuritem nga rufete !

20 Se n’u dashte te zhuritem,
Do zhuritem maje malit,
Po s’do qaj e s’do nemitem
I perulur,bri moçalit !

Jorgo Bllaci 1960

- Cili eshte kuptimi I titullit te poemes?
- Komentoni idene kryesore te poemes?
- Diskutoni mjetet artistike te perdorura nga autori?

SEKSIONI B

Shkruani nje ese per nje nga temat e meposhtme. Ju duhet te bazoni pergjigjen tuaj te pakten ne dy nga librat e Pjeses se trete, qe keni studiuar. Jeni te lejuar t'i referoheni librave te tjere, por keto nuk duhet te jene boshti kryesor i pergjigjes tuaj.

2. Analizoni rolin e nostalgjise per te shkuaren ose enderrat per te ardhmen ne veprat qe keni studiuar.
 3. Krahasoni rolin e personazheve negative ne veprat qe keni studiuar. Sa e rendesishme eshte prezenca e tyre dhe si kjo paraqitje e jep kontributin e saj per zhvillimin e permbajtjes ose te shprehjes se idese se autorit?
 4. Studioni rolin e shkaktuar nga konflikti ne veprat qe ju keni studiuar.
 5. Disa autore e shohin veten e tyre si “mesues” dhe veprat e tyre si “mesime”. Ne cfare aspekti mund te konsiderohen si “mesime” veprat qe keni studiuar?
 6. Krahasoni paraqitjen e temes dhe atmosferen ne te pakten dy nga veprat qe keni studiuar.
-